

VENDIM
Nr.400, datë 17.11.1990

PËR BLERJEN DHE KRYERJEN E SHËRBIMEVE JASHTË SEKTORIT SHTETËROR

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërmarrjet e institucionet lejohet të blejnë për nevojat e tyre nga kooperativat dhe privatët mjete kryesore, pajisje, mallra e materiale, si dhe të kryejnë shërbime kundrejt pagesës.

2. Vlerësimi i mjeteve kryesore, i pajisjeve, i mallrave dhe i materialeve, kur kanë çmime të miratuara, bëhet sipas këtyre çmimeve, kurse kur nuk kanë çmime të miratuara, vlerësimi bëhet me komision që ngrihet pranë ndërmarrjes dhe institucionit.

Veprat e artit vlerësohen sipas kriterëve që cakton Komiteti i Kulturës dhe i Arteve.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.107, datë 12.7.1968 “Për ndalimin e blerjeve dhe kryerjes së shërbimeve jashtë sektorit socialist”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Adil Çarçani